



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Prefekti i Qarkut Korçë, me shkresën nr. 12768, datë 28.06.2019, në vlerësim të situatës aktuale, për mos vënien në dispozicion të ambienteve për QV nr.3979, nr.3979/1, QV nr.3752, nga drejtuesit e institucioneve vendore, propozimit të KZAZ nr.70, i propozon KQZ-së të autorizojë ndryshimin e vendodhjeve të tyre.

Prefekti i Qarkut Kukës, me shkresën nr. 12799, datë 28.06.2019, bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në vlerësim të situatës aktuale, kërkesave shkresore të Bashkisë Kukës për mos vënie në dispozicion të ndërtesave në përgjegjësi administrimi, propozimeve dhe verifikimeve të kryera nga KZAZ nr.11, i propozon KQZ-së të autorizojë ndryshimin e vendodhjeve të katër Qendrave të votimit.

Kryetari i Bashkisë Has, me shkresën nr. 12500, datë 27.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 0549, për shkak të cilat pamundwsojnw funksionimin e kësaj ambientit si QV.

Kryetari i Bashkisë Roskovec, me shkresën nr. 12798, datë 28.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 3058, dhe dhënien e autorizimit për caktimin



e saj në Shkollën 9-vjecare Strum. Arsyeja e kërimit është amortizimi i ndërtesës ku ishte caktuar QV nr. 3058 shkak se (tavani I ndërtesës është shembur pjesërisht).

Kryetari i Bashkisë Sarandë, me shkresën nr. 12802, datë 28.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 4660, caktuar në Lokal Butrinti, dhe dhënien e autorizimit për caktimin e saj në objektin privat "Sadik Ogci

KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vlerëson situatën dhe propozimet e paraqitura, në funksion të zbatimit të rregullave dhe qetësisë së procesit zgjedhor të datës 30.06.2019.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 3, nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor nr.10, nr.11, nr.60, nr.70, nr.88 të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

